



Viti i VI-të i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2015

RRUGË DHE METODOLOGJI PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS SË GJEOGRAFISË NË ARSIMIN FILLOR

Bedri Kola

Albanian University

Adresë kontakti: bedrikola@yahoo.com

Përmbledhje

Përdorimi i një numri të madh rrugësh dhe metodash në mësimin e gjeografisë nga mësuesit është një përbërës thelbësor në procesin e zbatimit me sukses të kurrikulës së gjeografisë. Në këtë udhëzues për mësuesit e gjeografisë do të paraqesim disa metoda dhe teknika që janë të rëndësishme në aktivitetet gjeografike për arsimin fillor. Sigurisht, kushtet dhe nevojat e nxënësve, mësuesve dhe shkollave janë të ndryshme, prandaj disa metoda janë më të efektshme për disa, ndërsa për të tjerët jo. (1) Sugjerimet që do të japim më poshtë janë të përgjithshme, të provuara në praktikë dhe mund të përshtaten në kushtet dhe kërkesat e çdo shkolle.

Fjalët çelës: *Metodë, mësues, kurrikul, gjeografi.*

WAY AND METHODS IN THE TEACHING OF GEOGRAPHY TEACHERS IN ELEMENTARY SCHOOL

Abstract

The use of a great number of ways and methods in the teaching of geography teachers is an essential element in the process of successful implementation of the geography curriculum. This guide for the teachers of geography presents several methods and techniques which are important in geographical activities for primary education. The conditions and needs of students, teachers and schools are different therefore some methods are more effective for some, while others are not.

The suggestions given in this article are general, proven in practice and can be adapted to the conditions and requirements of each school.

Key words: *Methods, teacher, curriculum, geography.*

1. Çfarë do të mësojmë rreth vendeve të ndryshme(2)

Pavarësisht nga për zgjedhja e rrugëve dhe e metodave, njohuritë, shprehjet dhe qëndrimet e nxënësve; pra formimi i kompetencave mësimore në gjeografi janë rrjedhojë:

- e një procesi që kërkon nxitjen e nxënësve për t'iu përgjigjur pyetjeve, i përzgjedhjes së informacionit, i kërkimit të modeleve dhe i arritjes së konkluzioneve;
- e angazhimit të nxënësve në jetën e përditshme, e aktiviteteve që zhvillohen në klasë dhe atyre

jashtë klase në mjedisin e gjerë, ku ata jetojnë;

- e ndërtimit të një informacioni gjeografik rreth kërkesave të drejtpërdrejta për mjedisin, të atyre që u përkasin mjediseve të tjera, të cilat nxënësit i njohin dhe i sjellin në shkollë;
- e formimit të koncepteve gjeografike, përmes rimarrjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm;
- e nxitjes së entuziazmit dhe kureshtjes ndaj mjedisit;
- e zhvillimit të aftësive të bashkëpunimit, të komunikimit dhe të zgjidhjes së problemeve;
- e zhvillimit të qëndrimeve të përgjegjshme ndaj mjedisit;
- e zhvillimit të vlerave dhe qëndrimeve të tilla si respekti i ndërsjellë, toleranca, etj.

Kërkimi dhe studimi i vendit ku ne jetojmë dhe mësojmë, si dhe i vendeve të tjera, është përbërësi kryesor i kurrikulës së gjeografisë. Njohuritë dhe mësimi i karakteristikave të një numri vendesh është mbi të gjitha zemra e gjeografisë. Megjithatë, është e rëndësishme që në studimin e vendeve të ndryshme, të zbulohen dhe të studiohen jo vetëm karakteristikat e veçanta të vendeve të ndryshme, por dhe lidhjet e brendshme që ato kanë me botën në përgjithësi. Përvetësimi i njohurive për mjedisin natyror dhe shoqëror si dhe lidhjet ndërmjet tyre, zhvillimi i koncepteve, aftësive dhe përvetësimi i qëndrimeve të rëndësishme do të bëhet ndërmjet elementëve të ndërvarur të procesit të mësimi. Zbulimi dhe studimi i mjedisit vendor është futur në të gjitha nivelet e kurrikulës së gjeografisë dhe ndalet në tre aspektet e mësimi dhe zhvillimit. Një planifikim i mirë i studimit të mjedisit vendor do të bëjë gradualisht të thellohen njohuritë dhe shprehitë e nxënësve rreth popujve dhe të ardhmes se tyre në mjedisin ku ata jetojnë, atë që ne e quajmë mjedis vendor. Në lëndën e gjeografisë nxënësit do të provojnë zhvillimin e një numri të madh aftësish gjeografike dhe teknikash kërkimore që do të ndihmojnë në rritjen e njohurive të nxënësve rreth edukimit mjedisor. Studimi nga nxënësi i mjedisit ku mëson dhe jeton (gjë që është në qendër të kurrikulës së gjeografisë), nuk ka qëllim të kufizojë njohuritë e nxënësve për botën.

2. Çfarë duhet të mësojmë rreth një vendi

Vendi, mjedisi është në qendër të studimit të gjeografisë:

- Të kuptosh ku ndodhet një vend dhe cilat janë karakteristikat e tij dhe përse, është një nga objektivat kryesore të gjeografisë. (3)
- Kur bëhet eksplorimi i mjedisit të tyre ose vendeve të tjera, nxënësit mund të jenë kureshtarë të *zbulojnë* ku janë vendet të ndryshme dhe si janë shpërndarë pasuritë natyrore, shkaqet e kësaj shpërndarjeje, të *përcaktojnë* linjat e komunikacionit dhe të zbulojnë shkaqet, marrëdhëniet dhe pasojat e kësaj gjendjeje.
- Për të argumentuar një detyrë në gjeografi që lidhet me zbulimet që ata kanë bërë rreth mjedisit, gjeografët e vegjël përdorin një numër pyetjesh. Të gjitha pyetjet kryesore janë të lidhura më të gjitha mjediset, prandaj ne duhet të formojmë një listë me pyetje që fëmijët t'i përdorin për të gjitha mjediset e veçanta.
- Duke iu përgjigjur pyetjeve të tilla si:
 - Ku ndodhet një vend?
 - Çfarë pasurish natyrore janë zbuluar?
 - Përse një vend ka këto karakteristika?
 - Çfarë e dallon nga vendi ynë?
 - Çfarë ka të ngjashme me vendin tonë?

Ne i ndihmojmë fëmijët të bëjnë një përshkrim gjeografik.

3. Si të mësojmë për mjedisin e afërt

Mundësitë për të vizituar dhe për të njohur mjedisin e afërt janë thelbësore për realizimin e objektivave të gjeografisë. Vizitat, kërkimet gjeografike në mjedis dhe detyrat gjeografike janë aktivitete të rëndësishme për një numër arsyesh: (4)

- Ato nxisin interesat për mjedisin dhe e bëjnë mësimin e gjeografisë më të dashur dhe mësimdhënien e tij më aktive.
- Nxënësit ndërgjegjësohen që të mësojnë për mjedisin, për arsyet pse banorët e këtij ose atij vendi duhet të respektojnë pasuritë dhe karakteristikat e mjedisit. Duke mbajtur këtë qëndrim ndaj mjedisit të tyre, nxënësit zhvillojnë një aspekt të rëndësishëm të personalitetit të tyre.
- Detyrat gjeografike i lejojnë fëmijët që të zgjerojnë njohuritë dhe konceptet gjeografike që kanë marrë në klasë, dhe t'i vërtetojnë ato konkretisht në terren. Nxitja për të pyetur, formimi i shprehive të qëndrimit kritik për secilin nxënës, stimulimi për t'iu përgjigjur pyetjeve, zbulimi dhe njohja e pasurive të mjedisit, sugjerimet dhe të menduarit kritik janë disa nga arritjet e këtij procesi.
- Njohja e mjedisit përmes vizitave na çon në situata reale, që ndihmojnë në zhvillimin më të mirë e më të qëndrueshëm të aftësive dhe të koncepteve gjeografike.
- Vizitat gjeografike ushqejnë qëndrimin kritik në kuptimin e përgjegjësisë për kujdesin ndaj mjedisit.
- Ato kultivojnë punën në grup, punën vullnetare me kolektivin, me komunitetin. Takimi me njerëz të tjerë është i rëndësishëm, sepse zhvillon dhe forcon marrëdhëniet mes nxënësve dhe njerëzve në përgjithësi.
- Vizitat në terren i mësojnë nxënësit të krahasojnë dhe të zbulojnë ndryshimet që ka mjedisi ku ata jetojnë, mjedisi i afërt me vendet dhe popujt e tjerë të rruzullit tokësor.
- Bën të mundur integrimin e shumë elementëve të kurrikulës së historisë, të shkencave, të gjuhës dhe të arteve me gjeografinë.

4 . Përgatitja për të punuar në mjedis (5)

- Mësuesi përpara se të përdorë mjedisin e afërt për konkretizimin e njohurive dhe zgjerimin e koncepteve gjeografike, duhet të përgatisë një plan, ku duhet të vendosë me kujdes çfarë sipërfaqe ka mjedisi i afërt dhe çfarë mundësisht mundëson ai për studimin e karakteristikave dhe të proceseve gjeografike.
- Kurrikula e gjeografisë fillon nga klasa e tretë dhe vazhdon deri në përfundimin e arsimit të mesëm. Prandaj do të kihet parasysh nga mësuesit se mjedisi më i afërt për nxënësit është shtëpia dhe shkolla. Më rritjen e moshës së fëmijës zgjerohet edhe mjedisi i tij i afërt. Ky zgjerim i mjedisit shoqërohet edhe me zgjerimin e koncepteve dhe të njohurive tek fëmijët.
- Çdo mjedis ka çfarë të mundësojë për kërkime gjeografike.
- Mjedisi rural jep për njeriun shumë pasuri natyrore. Territori afër shkollës së bashku me fshatin shpërfaqin rezultatet e punës së njeriut dhe veprimtaritë që ai kryen në këtë vend. Marrëdhëniet e njeriut me mjedisin janë të dukshme në një numër prodhimesh dhe procesesh.

5. Si të organizojmë me nxënësit një detyrë, punë praktike në mjedisin që na rrethon(6)

Hapi i parë: Njohja e mjedisit

Kjo punë mund të fillohet në mjedisin përreth shkollës dhe synon zbulimin e veçorive, karakteristikave

gjeografike të këtij mjedisi. Vizitat që do të zhvillohen më tej në vende të tjera janë të domosdoshme dhe të rëndësishme për realizimin e objektivave të lëndës së gjeografisë. Këtu duhet të kujtojmë që, në vizitat në vende të tjera jashtë mjedisit të shkollës, fëmijët duhet të jenë të shoqëruar gjithnjë nga mësuesit, prindërit ose kujdestarë të tjerë të rritur.

Hapi i dytë: Përcaktimi i rreziqeve që paraqet mjedisi

Përcaktimi i vendeve të rrezikshme, është masa e parë paraprake e vizitave në terren dhe gjithnjë duhet shoqëruar me përshkrimin e masave parandaluese. Mjedise të rrezikshme në zonat urbane mund të jenë, për shembull, rrugët e ngushta dhe me kalldrëm, rrugët e rrëshqitshme ose me pengesa, rrugët me trafik të rënduar e të rrezikshëm etj., ndërsa në mjedise rurale mund të ndeshen rreziqe të tilla si, p.sh., vendet e larta ose të thepisura që kalohen me vështirësi, vendet me ujë, me bimë helmuese, me kafshë të rrezikshme, etj. Të gjitha këto rreziqe varen nga shumë faktorë, si: moshë, përvoja, numri etj. Për këtë arsye përgatitja e një udhëzuesi për të shmangur rreziqet ose për të bërë kujdes në vendet ku këto rreziqe nuk mund të shmanget është detyrë e shkollës dhe e mësuesit

Hapi i tretë: Konsultimet në shkollë

Mësuesi, përpara se të zhvillojë vizitën në mjedisin jashtë shkollës duhet të konsultohet me drejtorin e shkollës. Ky konsultim mund të bëhet për sigurimin e nxënësve, për transportin dhe për kërkesa të tjera të cilat mund të përfshihen në planin e shkollës. Nëse drejtori i shkollës ka kërkesa për veprimtari të ngjashme edhe nga mësues të tjerë, ai bën koordinimin dhe merr masat e nevojshme për organizimin e veprimtarive jashtë klase.

Hapi i katërt: Të zgjidhet veprimtaria në përputhje me moshën e nxënësve

Arsyeja kryesore e propozimit për punën me nxënësit në mjedis është ruajtja dhe kujdesi për mjedisin. Në këtë kuptim propozimi do të pasqyrohet edhe në kërkesat që do të plotësojnë fëmijët. Që veprimtaria të jetë e kënaqshme për nxënësit ajo duhet të përqendrohet në një numër i caktuar temash dhe procesesh. Në vijim puna duhet të ilustruhet me një numër veprimtarish kërkimore dhe zbuluese. Detyrat që do të kryejnë nxënësit varen nga një numër faktorësh, në radhë të parë nga mjedisi me karakteristikat e tij, nga tema nga moshë dhe nga vetë përvoja e fëmijëve. Në ndihmë të fëmijëve në këtë rast duhet të vihen të gjitha shkrimet, broshurat ose revistat që përmbajnë informacion për vendin që ata studiohet. Mësuesi duhet të bëjë kujdes që të vlerësojë punën e të gjithë nxënësit ose grupeve që plotësojnë detyra të veçanta në kuadrin e një studimi të përgjithshëm për atë vend.

Hapi i pestë: Përgatitja e nxënësve

Për të pasur sukses, është e rëndësishme të bëhet punë parapërgatitore për detyrat ose vizitat që nxënësit do të kryejnë jashtë klases.

- Së pari nxënësit duhet të njihen me disa veçori ose karakteristika të mjedisit, që ata do të zbulojnë si dhe me konceptet dhe shprehjet që lidhen me detyrën që do të kryejnë. Disa shprehje ata mund t'i praktikojnë që në klasë, si puna me hartën, bërja e planit, matje të ndryshme etj.
- Mësuesi duhet të mbajë parasysh faktin që gjatë punës mund të ketë ndonjë nxënësi që mund të bëjë hile, ndonjë tjetër mund të tregohet i pavëmendshëm ndaj rregullave të vendosura, veçanërisht ndaj porosive që lidhen me shmangien e rreziqeve në mjedisin jashtë shkollës ose me rregullat për ruajtjen e këtij mjedisi. Ai duhet t'i diskutojë këto çështje paraprakisht me nxënësit dhe kjo është një ndër aspektet kryesore të lëndës së gjeografisë.

Hapi i gjashtë: Informimi i prindërve

Prindërit duhen informuar për çdo aktivitet që kryhet jashtë shkolle. Mësuesit duhet të marrin të dhëna shëndetësore nga prindërit për çdo nxënës p.sh., për alergji ose gjendje të ndryshme të tyre shëndetësore si dhe telefonin shtëpisë dhe të urgjencës. Për çdo ndryshim që ndodh në klasë është mësuesi ai që informon prindërit.

Hapi i shtatë: Plan pune i detajuar i mësuesit, në të cilin të përfshihen:

- Informacioni për parashikimin e motit.
- Lista e pjesëmarrësve në punën që do të kryhet në mjedis, të ndarë në grupe, ku të jenë përcaktuar udhëheqësit e grupit.
- Nevojat e veçanta për shërbime shëndetësore për nxënës të veçantë, pas konsultimeve me prindërit.
- Numri i telefonit të urgjencës.
- Të përcaktohet puna që do të bëjnë grupet dhe çdo nxënës, gjatë gjithë kohës.
- Fletore shënimesh për nxënësit me udhëzimet përkatëse për punën që do të kryejnë.
- Harta e zonës.
- Mjetet e domosdoshme që nevojiten për punën që do të zhvillojnë nxënësit.
- Ushqimi, uji dhe pijet freskuese për nxënësit.
- Thes për të mbledhur mbeturinat.

6. Disa teknika kërkimi për studimin e mjedisit njerëzor

- Ka një numër të madh metodash dhe aktiviteteve, nëpërmjet të cilave, nxënësit mund të studiojnë mjedisin, të zbatojnë konceptet, njohuritë dhe shprehitë gjeografike. Mësuesi duhet të përzgjedhë disa prej tyre dhe t'i përdorë për detyrën që do t'ju japë nxënësve.
- Disa nga detyrat mund të plotësohen me një vizitë të vetme, ndërsa të tjera mund të kërkojnë kryerjen e disa vizitave, gjatë të cilave nxënësit duhet të mbajnë shënime ose të bëjnë vrojtime të vazhdueshme për një kohë të caktuar.

7. Vrojtimi dhe skicimi, hedhja e veçorive dhe e karakteristikave të mjedisit në fletoren e punës. Në këtë vërtetim dallojmë dy elementë:

- **I pari** është vërtetimi i karakteristikave të mjedisit dhe i përbërësve të tij.
- **I dyti** është analiza dhe qëndrimi kritik që nxënësit mund të mbajnë për çështje të caktuara që dalin në pah gjatë vërtetimit.

Këto elemente ndihmojnë që nxënësit t'iu përgjigjen dy pyetjeve të rëndësishme për gjeografinë:

- Cilat janë karakteristikat e një vendi?
- Përse ky vend ka këto karakteristika?

8. Disa aspekte që nxënësit duhet t'i kenë parasysh kur kryejnë detyrat gjeografike

a. Gjetja dhe njohja e detajeve dhe e karakteristikave të mjedisit (7)

Shënimet dhe fotografitë për karakteristikat e veçanta në fletoren e punës do të na ndihmojnë të kujtojmë ku

gjenden këto detaje ose veçori. Karakteristikat arkitekturore të çative, me majë ose në formë trekëndëshi, një dëshmi për tregtinë, ujësjellësi, gazsjellësi, kablli telefonik dhe të tjera karakteristika mund të futen në listën e karakteristikave të veçanta të mjedisit që studiojmë. Gjetja dhe studimi i këtyre karakteristikave të veçanta përbën një hap të rëndësishëm për zhvillimin e aftësive vrojtuese tek nxënësit.

b. Shënime dhe vizatime

Në plotësimin e shënimeve dhe të skicave gjatë punës kërkimore, nxënësit mund të pyesin për detaje ose veçori të ndryshme të mjedisit. P.sh., në fshat mund të pikturojë fushat, lumin, kodrat, madje mund të pyesë dhe të mbajë shënime për bimët që mbillen, për pemët që rriten pranë lumit dhe ato në majë të malit, për tipat e shtëpive, pajisjet e tyre, rrugët, komunikimin me pjesët e tjera të vendit, telefonin etj.

Nxënësit mund të kërkojnë të dhëna edhe me ndihmën e kompjuterit për elementë të veçantë të detyrës. p.sh., për ura, mure, diga, rrugë, stacione hekurudhore, ndërtesa etj. Kjo do t'i bëjë që t'i dallojnë këto karakteristika të ndryshme në mjedisin shoqëror, p.sh., tek një shtëpi të shikojnë çatinë, formën e saj, te muret të shohin materialet me të cilat janë ndërtuar etj.

c. Si të shkruajnë konkluzionet

Të gjitha sugjerimet e mësipërme janë të rëndësishme për t'u përqendruar dhe përzgjedhur informacionin për mjedisin. Kjo përbën fillimin e detyrës gjeografike. Është e rëndësishme që nxënësit t'i nxisin mendimet për karakteristikat e mjedisit që ata kanë parë dhe të arsyetojnë përse ky vend ka këto karakteristika. Nxënësit mund të përdorin shënimet që kanë mbajtur, vizatimet, fotografitë ose filmimet për përshkrimet e tyre, për formulimin e hipotezave që ata mund të shtrojnë si dhe për konkluzionet e tyre. Për shembull, nxënësve u kërkohet të nxjerrin karakteristikat e përbashkëta dhe të veçanta të pjesës së re dhe të vjetër të qytetit.

Pjesa e vjetër mund të ketë shtëpi me çati ndërsa pjesa e re i ka me terracë. Rrugët, te pjesa e vjetër, janë të ngushta dhe shtëpitë kanë oborr dhe kopsht përpara. Pjesa e re ka rrugë të gjera, sepse duhen për parkim dhe mungojnë oborret me avlli. Nga kjo nxënësit mund të nxjerrin përfundime për lëvizjen e njerëzve më përpara. Po ashtu, mund të shtrojnë problemet që ka sjellë trafiku i makinave për mjedisin. Shumë rrugë, për arsye të trafikut, janë bërë me një kalim dhe në disa zona është ndaluar qarkullimi me makina. Në fund atyre u kërkohen të sugjerojnë zgjidhje për trafikun që rëndohet përditë në qytetet tona.

d. Përshkrimi i sipërfaqes së tokës (8)

Mjaft karakteristika të mjedisit nxënësit mund t'i zbulojnë nëpërmjet përshkrimit të sipërfaqes së tokës. Kur flasim për sipërfaqen e tokës kemi parasysh, në radhë të parë, me çfarë është e mbuluar, me ujë, me bimë natyrale, me shkëmbinj, me rërë ose me bimë të mbjella nga njeriu, me ferma bujqësore dhe blegtorale, me rrugë automobilistike, hekurudhore, aeroporte ose me vende banimi. Këtë informacion nxënësit mund ta gjejnë edhe në harta, duke lexuar shenjat konvencionale. Harta të ndryshme kanë shenja të ndryshme konvencionale. Për këtë është i domosdoshëm shpjegimi paraprak nga mësuesi i këtyre shenjave. Për shembull, nëpërmjet ngjyrave nxënësit mësojnë, se sipërfaqe të ndryshme janë mbuluar me bar, lule, zhavorr ose shkurre etj. Nxënësit mund t'i plotësojnë këto në hartën skicë në orën e punë praktike në klasë, me ndihmën e mësuesit. Nxënësit mund të përshkruajnë ndërtesën e shkollës nga brenda ose një supermarket, një qendër shërbimesh dhe t'i vendosin këto në hartë.

Përcaktimi i vendndodhjes dhe i karakteristikave kryesore gjeografike është themeli për çdo detyrë në gjeografi. Një analizë rreth përdorimit të tokës është një punë e rëndësishme për studimin e mjedisit në qytete, fshatra ose ferma. Një hartë topografike me shkallë 1: 1000 ose një hartë e bërë nga mësuesi mund të përdoret nga nxënësit për të plotësuar sipërfaqet ndërmjet ndërtesave dhe rrugëve, duke vendosur me shkrim emra objektesh, si shkollë, spital, kishë, supermarket, park, etj. Në qoftë se nxënësi do të përdorë

IRrugë dhe metodologji për zbatimin e kurrikulës së gjeografisë në arsimin fillor

ngjyrat, ai duhet të ndërtojë një diagram, ku të shpjegojë përdorimin e tyre në hartë. Kjo vlen dhe për sipërfaqe të mbjella ose kullota për rritjen kafshëve ose shpendëve etj.

Që të realizohet detyra detyrë e tillë, është e nevojshme që në klasë të zhvillohet një punë e kujdesshme dhe e vazhdueshme me hartën, për të formuar shprehitë e punës me hartën tek nxënësit. Përshkrimi i veçorive të përgjithshme të sipërfaqes së një mjedisi i aftëson nxënësit për t'iu përgjigjur një numri të madh pyetjesh që janë të rëndësishme për gjeografinë, si p.sh.:

- Çfarë karakteristikash ka një vend?
- Përse është ky vend kështu?
- Çfarë ndryshimesh ka ky vend nga vendet e tjera?
- Çfarë ka të përbashkët ky vend me vende të tjera të rruzullit tokësor?
- Si është duke ndryshuar ky vend?

e. Intervista me njerëzit që jetojnë dhe punojnë në këtë mjedis

Një aspekt tjetër që duhet mbajtur parasysh kur studiojmë një mjedis shoqëror është të mësojmë për jetën dhe punët e banorëve të zonës. Për këtë lloj aktiviteti mund të përdorim dy rrugë:

- Të ftojme në klasë njerëz të ndryshëm dhe nxënësit të zhvillojnë pyetje për ta
- Të shkojmë në një fabrikë, punishte, uzinë ose fermë.

Këto vizita janë të frytshme dhe mjaft të rëndësishme për nxënësit por kërkojnë një punë përgatitore e të kujdesshme nga mësuesi. Kur intervistat bëhen gjatë vizitave në një qendër prodhimi, i ndihmojnë fëmijët të njohin profesionet, kushtet e punës si dhe prodhimet e ndryshme për të cilat ka nevojë shoqëria. Po kështu, atyre u jepet mundësia të kuptojnë si ndërvarët puna e një individi nga ajo e të tjerëve në një fabrikë. Kjo mund të bëhet edhe gjatë vizitës në një fermë, ku nxënësit mund të njihen, për shembull, me prodhimet që eksportohen ose importohen, me veçoritë e veçoritë e transportit, të kulturës dhe të arritjeve të një rajoni tjetër.

f. Vlerësimi i mjedisit

Qëndrimet e nxënësve ndaj mjedisit janë një aspekt i rëndësishëm i formimit të tyre, pasi ai i ndihmon ata të shikojnë në mënyrë kritike mjedisin e tyre ku jetojnë dhe mësojnë dhe të vlerësojnë e japin mendimet e tyre kur diskutohet për lidhjet e mjedisit me jetën e njerëzve. Kështu, ata mund të bëhen qytetarë aktivë për mbrojtjen e mjedisit nga dëmtimet.

Veprimtaritë për vlerësimin e mjedisit mund të bëhen në të gjitha klasat e shkollës. Nxënësit vrojtojnë aspekte të veçanta të mjedisit dhe përcaktojnë çfarë është e bukur e çfarë nuk është e bukur në të dhe, në këtë nivel, gjykimet e tyre bëhen në duke përdorur kategoritë morale “e mirë” dhe “e keqe”. Po ashtu ata japin vlerësime të argumentuara e të mbështetura në fakte, bëjnë analiza dhe japin mendime se si mund të përmirësohet mjedisi.

g. Zbulimi i lidhjeve të elementëve të mjedisit(9)

Detyrë e mësimit të gjeografisë është jo vetëm nxjerrja në pah e karakteristikave të mjedisit, por edhe i lidhjeve që ekzistojnë mes tyre. Në këtë rast nxënësit mund t'iu përgjigjen pyetjeve të tilla si:

- Përse ky vend ka këto karakteristika gjeografike?
- Si lidhet ky vend me vendet e tjera të rajonit ose të botës?
- Ku ndodhet ky vend?

Për nxënësit e shkollës së mesme mund të jepet si detyrë lokalizimi i rrugëve që lidhin këtë vend me vendet e tjera. Këto nxënësit i identifikojnë, duke punuar në hartë. Ata mund të bëjnë analizën e rrugëve kryesore

ose jo kryesore, të gjera ose të ngushta, të asfaltuara ose të pa shtruara etj. Ata mund të përcaktojnë lidhjet e mjedisit që studiojnë me vendet e tjera si dhe llojet e rrugëve me të cilat lidhet ai, distanca nga vendet e tjera etj.

h. Rëndësia e eksperimentimit në mjedisin shoqëror

Nxënësit mund të përfshihen në eksperimente të ndryshme që lidhen me cilësinë e materialeve të ndërtimit, me shkallën e ndotjes së mjedisit etj. Kështu ata mund të kryejnë eksperimentet e mëposhtme:

- Mund të marrin në kampion të materialeve të ndërtimit për të testuar fortësinë dhe cilësinë e tij
- Mund të shqyrtojnë zhurmat në mjedis duke përdorur audiokasetat në mjedise ku të tjerët shëtisin ose lexojnë.
- Mund të studiojnë ndotjen e ajrit në vende të ndryshme të qytetit etj.

9. Çfarë duhet të mësojnë nxënësit për mjedisin natyror

Studimi i karakteristikave të mjedisit natyror nga nxënësit synon të arrijë tre qëllime kryesore:

- Të aftësojë nxënësit të zbulojnë dhe përcaktojnë karakteristikat e përbashkëta, themelore të mjedisit natyror.
- Të zhvillojë tek nxënësit aftësitë për të përcaktuar rrugët e formimit të veçorive të mjedisit, si kanë qenë dhe si ato po ndryshojnë.
- Të nxisë nxënësit të zbulojnë dhe të mësojnë lidhjet ndërmjet elementëve të mjedisit natyror dhe bimëve, kafshëve dhe njerëzve.

Studimi i mjedisit natyror zhvillohet në të gjitha klasat e shkollës 9-vjeçare dhe nuk zhvillohet i ndarë nga mjedisi shoqëror. Mjedisi natyror ekziston në të gjithë Shqipërinë, në trojet e tjera shqiptare, si dhe në të gjithë rruzullin tokësor. Ndikimin e shoqërisë njerëzore në mjedis e gjen në çdo pjesë të vendit.

Disa shkolla mund të jenë vendosur në vende me karakteristika të veçanta që janë të mundshme për t'u studiuar, p.sh., në bregdet shkëmbor, në tokë moçalore, në një pyll natyror etj. E rëndësishme është paraqitja e bimësisë, e kafshëve dhe e karakteristikave, e veçorive fizike të këtyre vendeve që mund të shfrytëzohen nga njeriu. (10)

Megjithatë, shumica e shkollave do të gjejnë në mjediset e tyre shembuj për studimin e veçorive të mjedisit natyror. Këto mund t'i fusin në studimet që do të bëjnë me nxënësit për karakteristikat e mjedisit si relievi kodrinor ose malor, e një liqeni, e një lumi ose e një kënete etj.

Duhet të rikujtojmë, se shumë procese natyrore mund të vëzhgohen në mjedise ku kanë ndodhur për arsye të aktiviteteve njerëzore, si p.sh., një gardh ose mur rrethues i vjetër, një varrezë e vjetër ose një gropë plehrash e vjetër, të cilat tani i janë lënë ndikimit të natyrës.

Studimi i mjedisit të afërt të krahasohet me atë të Shqipërisë, të Evropës dhe me mjedisin në pjesë të tjera të Botës.

10. Si të njohim dhe zbulojmë karakteristikat e mjedisit nga fotografitë

Mbledhja, emërtimi, formimi i ekspozitave dhe ekzaminimi i fotografive, i karakteristikave të mjedisit, luan një rol të rëndësishëm në formimin e koncepteve tek nxënësit për veçoritë e mjedisit. Edhe revistat gjeografike, fletëpalosjet e agjencive të udhëtimit, gazetat ose fotografitë ajrore etj. janë burime materiale për t'i përdorur nxënësit në klasë (jo vetëm në klasat e ulëta). Fotografitë ajrore luajnë një rol të madh për zbulimin dhe përcaktimin e karakteristikave të mjedisit. Këto lënë gjurmë tek nxënësit dhe krijojnë për

mjedisin përfytyrime më të qarta se harta topografike.

11. Ndërtimi i modeleve të mjedisit

Ndërtimi i modeleve të mjedisit përdoret për të ilustruar dhe për të mësuar rrugët në të cilat ndodhin shumë procese natyrore në sipërfaqen e tokës. Duke përdorur materiale të ndryshme mund të krijohen modele të atilla, që të pasqyrojnë ndikimet e ujit që rrjedh. Megjithatë duhet të kemi kujdes, sepse ndryshimet mes asaj që ndodh në një luginë lumi dhe asaj që ndodh në modelin e ndërtuar, janë të mëdha dhe ekziston mundësia e krijimit të përfytyrimeve jo të sakta tek nxënësit. Prandaj sugjerojmë që modelet të shoqërohen me punën eksploruese të nxënësve në mjedisin natyror.

Referenca

1. ISP. (Instituti i Studimeve Pedagogjike), *Kurrikula, bazat, parimet dhe problemet*. Tiranë 2003, f. 2-3.
2. Oliva, F.P., *Developing the curriculum*, Boston 1982, f. 19-20.
3. IZHA, *Standardet e përmbajtjes së kurrikulës së gjeografisë*, Tiranë 2013, f. 13.
4. Kola Bedri, *Kurrikuli i arsimit 9 vjeçar*; Shtëpia botuese Kristalina, 2006, f. 134-150.
5. Bërzhollli Arqile, *Gjeografi e Kontinenteve*, 2011, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, f. 8-9.
6. Kola Bedri, *Shkenca e Tokës*, IKS, Tiranë, 2010, Libër për mësuesit e gjeografisë, f. 21-25.
7. Earth Science, (Shkenca e tokës), USA, Prentice Hall, 1995, f. 87-90.
8. Teacher Guidelines, Government of Ireland, 1999, *Social, Enviromental and Scientific Education*, f. 210-215.
9. Glencoe, Macmilan/McGraw-Hill, Teksas State University, *World Geografy*, 1995, f. 4.
10. Sula Gerta, *Të nxënë: nga teoria në praktikë*, Botimet Kumi, 2012, f. 10-15.